Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në Fazën e fundit të përgatitjes për Regjistrimin e Popullsisë (ReKos 2024)

13 mars 2024

Stafi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) është duke hyrë në fazën finale të përgatitjes së procesit të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (ReKos 2024). Me ekipin e saj të përkushtuar dhe organizimin sipas planit, ASK-ja është duke i rishikuar të gjitha instrumentet dhe është në fazën finale teknike të çdo aktiviteti të nevojshëm për këtë fazë.

Janë disa grupe punuese të angazhuara në të njëtjën kohë që janë të sinkronizuar dhe të planifikuar në kohë.